



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

UNIVERSITY OF PRIZREN

“UKSHIN HOTI”

Rektorati

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

ZYRA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORT I PUNËS DHE I SHPENZIMIT TË BUXHETIT

PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR

2022

JANAR, 2023

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
HYRJE.....	4
II - PAGAT DHE SHITESAT (Kodi 111-Pagat mujore me orar të plotë)	8
III - MALLRAT DHE SHËRBIMET (Kodi 130-Mallra dhe shërbime)	9
IV - TATIMI I NDALUR NË BURIM PËR PAGESAT SIPAS KONTRATAVE TË POSAÇME PËR PERIUDHËN I-XII 2022	11
V - SHPENZIMET KOMUNALE- Kodi 132.....	13
VI - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE-Kodi 200.....	14
VII - INVESTIME KAPITALE- Kodi 300.....	14
VIII – DONACIONET	15
XII - TË HYRAT VETANAKE-Kodi 500	16
X- PARAJA E IMËT (CASH)	18
XI - OBLIGIMET E PAPAGUARA TË BARTURA NGA VITI 2021	18
XII - REKAPITULIM – PLANI DHE SHPENZIMI I TËRËSISHËM I BUXHETIT TË LEJUAR PËR PERIUDHËN I-XII 2022	19
XIII - PËRFUNDIME	20
XIV - BURIMET E TË DHËNAVE	21
XV – SHITESAT.....	21

SHKURTESAT

BK- Buxheti i Kosovës

MFPT - Ministria e Financave, Punes dhe Transfereve

KASH – Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

UUHP - Universiteti Ukshin Hoti në Prizren

MASHTI- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

SIMFK – Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

TKP – Trusti i Kursimeve Pensionale

TMB – Tatim i Mbajtur në Burim

KBP - Kodi Buxhetor i Projektit

OE - Operator Ekonomik

SMU – Sistemi i Menaxhimit të Universitetit

OSHP – Organi Shqyrtues i Prokurimit

HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, Neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutit të Universitetit të Prizrenit neni 28 për përgjegjësitë e Rektorit pika 1.9 lidhur me menaxhimin e buxhetit dhe mjeteve në kuadër të shumës së miratuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, Rektori i Universitetit të Prizrenit përmes Zyres për Buxhet dhe Financa ka hartuar raportin mbi planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar/Dhjetor të vitit fiskal 2022.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të planifikuara të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2022/2024, vendimeve nga niveli qendror (MFPT, MASHTI), rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit. Periudha raportuese për Universitetin e Prizrenit, karakterizohet për realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të cilat janë të pasqyruara në Planin Strategjik për zhvillimin e Universitetit për vitet 2020/2024 Nr. proto. 01/502A.

Rezultatet e pritura ishin të varura nga buxheti (Granti Qeveritar) për të përmbushur obligimet për funksionimin e mirfilltë të Universitetit.

Raporti pasqyron se në ç'mënyrë institucioni i Universitetit të Prizrenit bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2022, administroi burimet financiare dhe shpenzimet gjatë periudhës së raportimit.

Raporti financiar është bazuar në këto dokumente:

1. Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048
2. Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024.
3. Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 Nr. 08/L-066
4. Statutin e Universitetit të Prizrenit.
5. Buxhetin për vitin 2022 për Universitetin e Prizrenit
6. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2022 Nr. 08/L-066.

Raporti Financiar është i harmonizuar me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosoves (SIMFK).

I-BUXHETI I LEJUAR PËR UUHP NGA BUXHETI I KOSOVËS


Buxheti për Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr.08/L-066 për vitin 2022 është 3,143,728.00 €, që krahasuar me buxhetin e vitit 2021 është me i lartë për 540,000.00 € ose 20.74%.

Ndërsa me rishikim buxhetor nga BK, Universitetit i janë lejuar gjithsej, 3,600,800.68 €.

Tabela nr. 1-Buxheti i strukturuar në kategori ekonomike

NR.	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2022	Buxheti me rishikim për vitin fiskal 2022
1	PAGA DHE SHTESA	2,070,728.00	2,527,800.68
2	MALLRA DHE SHËRBIME	700,000.00	730,000.00
3	SHPENZIME KOMUNALE	73,000.00	43,000.00
4	SUBVENCIONE	100,000.00	100,000.00
5	INVESTIME KAPITALE	200,000.00	200,000.00
	GJITHSEJ	3,143,728.00	3,600,800.68

Grafiku nr. 1- Paraqitja grafike e buxhetit fillestar për vitin 2022



Grafiku nr.2 - Paraqitja grafike e buxhetit me Rishikim 2022



Tabela nr. 2- Buxheti i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2021	Buxheti për vitin fiskal 2022
1	PAGA DHE SHTESA	1,650,728.00	2,070,728.00
2	MALLRA DHE SHËRBIME	600,000.00	700,000.00
3	SHPENZIME KOMUNALE	73,000.00	73,000.00
4	SUBVENCIONE	100,000.00	100,000.00
5	INVESTIME KAPITALE	180,000.00	200,000.00
	GJITHSEJ	2,603,728.00	3,143,728.00

Paga dhe shtesa- për vitin fiskal 2022 Shuma buxhetore e planifikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2,070,728.00 € që është për 420,000.00€ më e lartë se shuma e pagave dhe shtesave të planifikuara për vitin 2021.


Mallra dhe shërbime - Shuma buxhetore për këtë kategori është 700.000.00€ që është për 100,000.00€ më shumë se shuma e ndarë buxhetore për vitin 2021.

Shpenzime Komunale- janë 73,000.00, që mbesin në nivelin e vitit fiskal 2021.

Subvencionet- mjetet e planifikuara 100.000.00 €, janë në nivel të njëjtë me mjetet e ndara buxhetore të vitit 2021.

Investime kapitale- mjetet e planifikuara janë në shumë 200.000.00 €, krahasuar me vitin 2021 kemi shtim të buxhetit për 20,000.00 €.

Grafiku nr. 3- Paraqitja grafike e buxhetit 2022/2021



Për vitin akademik 2022 buxheti i lejuar nga burime të Buxheti i Kosovës dhe nga Donacionet për Universitetin e Prizrenit është si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3- Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar gjatë vitit 2022 nga BK dhe Donacionet

Nr. Rend.:	Kategoria ekonomike	Buxheti sipas planit të shpenzimit të rrje.se parase 2022	Rishikimi buxhetor 2022	Buxheti i shpenzuar- 2022	Shpenzimet e Donacione dhe Projekte
1	2	3	4	5	6
1	Pagat dhe shtesat (BK)	2,070,728.00	2,527,800.68	2,527,800.68	-
2	Mallra dhe shërbime	700,000.00	730,000.00	628,422.99	44,519.52
3	Shpenzimet komunale	73,000.00	43,000.00	37,607.87	
4	Subvencionet dhe transferet	100,000.00	100,000.00	99,446.40	
5	Investimet kapitale	200,000.00	200,000.00	181,179.19	8,990.00
	Gjithsej	3,143,728.00	3,600,800.68	3,474,457.13	53,509.52

Kategoria Pagat dhe shtesat gjatë periudhës Janar/Dhjetor/2022 janë mbuluar në tërësi nga Granti Qeveritar (Total 2,527,800.68 €).

Shpenzimet e planifikuara për vitin 2022 të Universitetit janë 3,143,728.00 €, me rishikim buxhetor janë ndarë mjete shtesë në kategorinë Pagat dhe shtesat, ku kemi ndryshim të shumës nga planifikimi. Me Rishikim shuma e buxhetit të ndarë kap shifren 3,600,800.68 €. Shpenzime të realizuara gjatë vitit 2022 janë 3,474,457.13 €. Përshirë donacionet shuma e shpenzuar gjatë vitit 2022 nga UUHP është 3,527,966.65

Buxheti i lejuar fillestar vjetor, në tabelë, është në kolonën numër 3

Buxheti i ndarë me Rishikim është sikur në kolonën 4

Buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2022 është sikur në kolonën 5.

Buxheti i shpenzuar për projektet e financuara nga donatorët është paraqitur në kolonën 6.

PLANI I RRJEDHËS SË SHPENZIMIT TË PARASË PËR VITIN 2022

Tabela nr. 4- Plani i rrjedhës së shpenzimit të parasë për vitin 2022

PERIUDHA	PAGAT DHE SHTESAT	MALLRA DHE SHËRBIME	SHPENZIME KOMUNALE	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	PASURITË JOFINANCIARE (KAPITALET)	TOTAL
JANAR	172,560.67	-	-	-	-	172,560.67
SHKURT	172,560.67	80,000.00	9,000.00	-	-	261,560.68
MARS	172,560.67	48,000.00	8,000.00	-	110,000.00	338,560.66
PRILL	172,560.67	167,000.00	6,000.00	-	-	345,560.66
MAJ	172,560.67	80,000.00	6,000.00	100,000.00	10,000.00	368,560.66
QERSHOR	172,560.67	37,000.00	5,000.00	-	-	214,560.66
KORRIK	172,560.67	83,000.00	5,000.00	-	15,000.00	275,560.66
GUSHT	172,560.67	40,000.00	5,000.00	-	-	217,560.66
SHTATOR	172,560.67	30,000.00	6,000.00	-	65,000.00	273,560.66
TETOR	172,560.67	75,000.00	6,000.00	-	-	253,560.66
NËNTOR	172,560.67	30,000.00	8,500.00	-	-	211,060.66
DHJETOR	172,560.67	30,000.00	8,500.00	-	-	211,060.66
TOTAL	2,070,728.00	700,000.00	73,000.00	100,000.00	200,000.00	3,143,728.00

II - PAGAT DHE SHTESAT (Kodi 111-Pagat mujore me orar të plotë)

Buxheti i lejuar për paga dhe shtesa, i ndarë fillim ishte 2,070,728.00 €. Me Rishikim buxhetor kjo shumë është shtuar në vlerë 2,527,800.68 €. Ky buxhet është shpenzuar si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5- Pagat e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren me ndalesa ligjore sipas muajve I-XII:

Kodi ekonomik :	Paga Neto sipas L.P.	Tatimi	Kontributi Pun.:	Sindikati:	Kontributi i Punëdh:	Paga dhe shtesat	Pagesa për vendime gjyqësore:	Nr. i punët. List pagave	Nr.i punët efektiv:
Periudha	11110	11500	11600	11115	11700	11900			
Janar	336,373.67	33,076.27	18,580.01	385.91	18,580.01	406,995.87		242	238
Shkurt	159,629.00	13,963.11	8,836.64	298.17	8,836.64	191,563.56		246	238
Mars	161,590.19	14,702.06	9,130.02	322.28	9,130.02	194,874.57		248	132
Prill	215,431.99	20,019.44	12,033.36	340.01	12,033.36	259,858.16		227	207
Maj	204,296.88	18,823.58	11,259.86	334.75	11,259.86	245,974.93		227	216
Qershor	196,259.55	17,883.00	10,841.26	399.23	10,841.26	236,959.01	734.71	224	217
Korrik	144,822.56	12,871.56	7,977.97	355.56	7,977.97	174,005.32		224	141
Gusht	154,494.92	13,920.89	8,560.61	377.73	8,560.61	185,806.76		224	144
Shtator	138,825.43	12,129.18	7,621.93	0	7,621.93	166,198.47		224	137
Tetor	127,721.09	11,083.90	7,306.73	24.3	7,306.73	153,442.75		218	167
Nëntor	129,461.46	11,275.80	7,408.79	30.97	7,408.79	155,585.81		220	220
Dhjetor	130,254.73	11,339.52	7,454.02	33.18	7,454.02	156,535.47		227	227
Gjithsej I-XII:	2,099,161.47	191,088.31	117,011.20	2,902.09	117,011.20	2,527,800.68	734.71	Mes. 230	Mes. 173

Nga të dhënat në tabelë shihet se shpenzimi i buxhetit për paga dhe shtesa për periudhën vjetore është **122.07 %** ose 22,07% më i lartë se shuma fillestare e planifikuar për t'u shpenzuar për vitin 2022. Shuma e shpenzuar për kategorinë Pagat dhe Shtesat është 2,527,800.68 €. Diferenca shtesë - 457,072.68 €.

Shënim 1.: Kjo situatë është e ngjajshme vite me radhë, kur fondi i planifikuar për paga dhe shtesa ishte vite me radhë i pamjaftueshëm, prandaj janë mbuluar me rishikim buxhetor.

Edhe pse janë ndarë mjete shtesë me Rishikim këto mjete nuk kanë mjaftuar të kryhen pagesat e personelit akademik të angazhuar në semestrin dimror 2022/2023 (shih obligimet e pa paguara për paga të pjesa shtesë e këtij Raporti).

Shënim 2.: Numri mesatar i punëtorëve efektiv është 173 në muaj.

Shënim 3.: Shuma prej **734.71€** është debituar nga fondi i ndarë për paga dhe shtesa sepse thesari ishte i detyruar të paguaj këtë shumë sipas vendimit të përmbauesit privat.

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit, 2019, 2020 dhe 2021, shpenzimi i buxhetit për paga është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 6- Shpenzimi i buxhetit për paga në krahasim me vitet e mëparshëm

Kodi buxhetor 11	Shpenzimi I-XII 2018	Shpenzimi I-XII 2019	Shpenzimi I-XII 2020	Shpenzimi I-XII 2021	Shpenzimi I-XII 2022
Janar	225,559.99	114,542.21	135,136.32	224,424.42	406,995.87
Shkurt	201,927.22	284,451.37	136,251.92	200,616.68	191,563.56
Mars	112,188.54	134,631.45	137,171.05	160,014.69	194,874.57
Prill	221,133.10	271,073.50	248,045.62	257,588.87	259,858.16
Maj	199,987.48	222,735.28	263,896.32	244,187.90	245,974.93
Qershor	188,808.33	229,120.18	201,732.72	234,459.26	236,959.01
Korrik	152,265.35	181,664.24	150,453.24	158,460.21	174,005.32
Gusht	122,048.00	132,899.57	143,692.15	154,595.52	185,806.76
Shtator	112,699.34	124,623.17	143,325.35	149,432.24	166,198.47
Tetor	116,820.23	139,620.90	165,407.81	146,819.04	153,442.75
Nëntor	197,601.92	188,203.46	157,508.05	152,435.66	155,585.81
Dhjetor	213,209.30	225,788.50	326,403.85	147,277.20	156,535.47
TOTALI:	2,064,248.80	2,249,353.83	2,209,024.40	2,230,311.69	2,527,800.68
Indeksi zingjir:	-	108.97	98.21	100.96	113.34
Indeksi bazë:	100.00	108.97	107.01	108.04	122.46

Shpenzimi për pagat bruto gjatë vitit 2022 ishte më i lartë se sa ai i vitit 2021 për 13.34% të indeksit zingjir, ose për 22.46 % më të larta sipas indeksit bazë të viti 2018.

III - MALLRAT DHE SHËRBIMET (Kodi 130-Mallra dhe shërbime)

Sipas planit të shpenzimit të rrjedhës së parasë në vitin 2022 ishin planifikuar të shpenzohen për këtë kategori ekonomike 700,000.00 €.

Shuma e shpenzuar gjatë vitit 2022 për kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime është 628,422.99 €, ose 89.77 % e planit vjetor.

Kemi kërkuar bartjen e mjeteve në vlerë 30,000.00 € nga kategoria Shpenzimet komunale në kategorinë Mallrat dhe shërbimet, por kjo ndarje buxhetore është realizuar në javën e fundit të vitit kalendarik, kur ishin mbyllur mundësitë e realizimit të pagesave pasi që zotimet mund të kryhen më së voni deri me 12 Dhjetor të vitit kalendarik (pa procedurë të prokurimit).

Sipas muajve, shpenzimi i buxhetit krahasuar me planin ishte si më poshtë:

Tabela nr.7- Shpenzimi i buxhetit për kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime

Muaji:	Plani I-XII '22	Shpenzimi I-XII '22	Shp/PlanXII*100
1	2	3	4(3:2)
Janar	-	0.00	0.00%
Shkurt	80,000.00	-	0.00%
Mars	48,000.00	71,372.78	148.69%
Prill	167,000.00	56,846.51	34.04%
Maj	80,000.00	41,929.49	52.41%
Qershor	37,000.00	21,774.88	58.85%
Korrik	83,000.00	78,511.91	94.59%
Gusht	40,000.00	-	0.00%
Shtator	30,000.00	36,160.34	120.53%
Tetor	75,000.00	93,485.79	124.65%
Nëntor	30,000.00	63,546.62	211.82%
Dhjetor	30,000.00	168,214.67	560.72%
Gjithsej: I-XII	700,000.00	631,842.99	90.26%

Shumës totale të shpenzuar për kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve prej 631,842.99 € duhet minusuar shuma e Avancit për Patty Cash prej 1,000.00€, e cila është mbyllur para përfundimit të vitit fiskal si dhe shuma e Avancit për udhëtim zyrtar prej 2,420.00€, që ka qenë e pa mbyllur në muajin shtator 2022, e që në periudhën pasuese, në muajin Tetor është mbyllur.
Pra 631,842.99 -1,000.00 - 2,420.00 = 628,422.99

Sipas Kodeve të kësaj kategorie ekonomike, shpenzimi i buxhetit për periudhën I-XII /2022 ishte si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 8- Shpenzimi i buxhetit për Mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike

KODI:	EMËRTIMI I KODIT:	I-XII/2022
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit- kompensimi i udhëtimeve (karburant ose biletë autobusi)	298.21.00
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit- Vizitat studimore të studentëve dhe stafit brenda vendit përmes kompanise së kontraktuar nga AQP	4.900.00
13132	Akomodimi i udhëtimeve zyrtare brenda vendit – Për Profesor mysafir në Shkollën Ndërkombëtare Verore	2,403.00
13132	Akomodimi i udhëtimeve zyrtare brenda vendit – Për Profesor mysafir në Konferencën Ndërkombëtare “Bridge 2022”	597.00
13140	Shpenz. e udhëtimit zyrtar jashtë vendit ¹	23,067.05
13141	Spensime të vogla-para xhepi	6,324.80
13142	Akomodim jashtë vendit	4,089.92
13143	Shpenzimet tjera-udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	6,866.74
13144	Shpenzimet e transportit për udhëtime zyrtare jashtë vendit	3,415.13
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	14,380.00
13330	Shpenzimet postare	23.40
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	10,195.00
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	9,806.00
13460	Shërbime kontraktuese tjera	40,110.78
13480	Shpenzimet për anëtarësim	29,302.00
13501	Mobilje (më pak se 1000 €)	970.00
13503	Kompjuter (me pak se 1000 €)	50,442.02
13509	Paisje tjera (më pak se 1000 €)	42,798.65
13610	Furnizime për zyrë	3,224.70
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) ujë për personelin e UUHP – Kontratë me AQP	1,234.00
13620	Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)- pije, lengje dhe kafe te bufeja e UHHP	4,661.60
13620	Furn. me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) – Koktej për Shkollën Ndërkombëtare Verore	200.00
13720	Naftë për ngrohje qendrore	59,852.00
13760	Dru	48,000.00
13780	Karburant për vetura	6,791.43
13820	Avanc per udhetime zyrtare	1,800.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	105.00
13951	Sigurimi i automjeteve	469.10
13953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	50,100.00

¹ Këtu hyjnë edhe vizitat e studentëve dhe stafi jashtë vendit.

14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	4,036.47
14020	Mirëmbajtja e ndërtesave	108,183.14
14023	Mirëmbajtja e shkollave	5,604.70
14040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	6,183.77
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe e pajisjeve	10860.99
14140	Qeraja për makineri	2,717.00
14220	Botimet e publikimeve	10,872.50
14310	Dreka zyrtare	3,965.30
14310	Dreka zyrtare – Darka e fundvitit 2021	1,365.00
14310	Dreka zyrtare- Shpallja Dr.Honoris Causa Christopher S.Hyland	400.00
14310	Dreka Zyrtare- Hapja e QKITD në ITP	200.00
14310	Dreka zyrtare- Konferenca Ndërkombëtare “Bridge 2022” UUHP (Dy dite)	2.100.00
14320	Drekat zyrtare jashtë vendit	49.86
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	45,326.73
14415	Pagesat për tarifa-vendimet gjyqësore/përmbartimore	80.00
Gjithsej		628,422.99

Të dhënat e detajuara të shpenzimit të buxhetit sipas kodeve, muajve, shumave dhe operatorëve ekonomikë janë dhënë në **Shtesën e posaçme XIV**.

IV - TATIMI I NDALUR NË BURIM PËR PAGESAT SIPAS KONTRATAVE TË POSAÇME PËR PERIU DHËN I-XII 2022

Duke filluar nga muaji **Maj 2016** jemi obliguar që ta aplikojmë ndaljen e tatimeve në burim (Ligji Nr. 05/L-029 – Neni 30) dhe pagesen e tyre në ATK të tatimeve dhe kontributeve pensionale sipas **Kontratave për shërbime të veçanta**.

Tabela nr.9- Pagat, Kontributet dhe Tatimet e ndalura në burim

Muaji:	Paga bruto:	5% kontrib. i punët.:	5% kontrib. i punëdh.:	Tatimi:	Paga neto:
1	2	3	4	5	6= (2-3-5)
Janar	-	-	-	-	-
Shkurt	-	-	-	-	-
Mars	160.00	8.00	8.00	2.88	149.12
Prill	5,066.54	506.65	-	455.99	4,103.90
Maj	-	-	-	-	-
Qershor	400.00	20.00	20.00	-	380.00
Korrik	8,298.10	829.80	-	788.32	6,679.98
Gusht	-	-	-	-	-
Shtator	-	-	-	-	-
Tetor	4,800.00	-	-	480.00	4,320.00
Nëntor	27,044.89	435.75	435.75	2,455.24	24,153.90
Dhjetor	2,430.00	1.50	1.50	242.85	2,185.65
Gjithsej:	48,199.53	1,801.70	465.25	4,425.28	41,972.55

Siç shihet nga tabela, gjatë kësaj periudhe në muajin mars dhe qershor në kategorinë ekonomike të shërbimeve kontraktuese tjera janë paguar, kompenzuar nga kodi burimor i buxhetit të Kosovës-10, dhe për të njëjtat pagesa janë tatimuar me tatimin e ndalur në burim, për 2.88€ kurse nga i njëjti burim-10 janë paguar edhe kontributet pensionale në Trustin Pensional të Kursimeve 28.00€ nga pagesa bruto si dhe 28.00€ nga punëdhënësi-Universiteti.

Në muajin Prill po për shërbime kontraktuese tjera nga donatori i projektit SMART 4ALL(94973) pra nga kodi burimor-49 janë kompenzuar 5 punonjës të Universitetit me gjithsej shumën bruto prej 5,066.54€. Tatimi në burim i ndalur është 455.99€ kurse kontributi pensional është 506.65€.

Kurse ne muajin Korrik nga dy projekte-RESEARCH CULT(92085) dhe ai DI-PHIDICTES(92089) nga kodi burimor-49 janë kompenzuar 19 punonjës të Universitetit me gjithsej shumën bruto 8,298.10€. Tatimi në burim i ndalur është 788.32€ kurse kontributi pensional është 829.8.0€

Pasi që Ligji Nr. 05/L-029 – Neni 30 i obligon të gjithë punëdhënësit të ndalin në burim dhe të paguajnë në llogarinë e ATK-së obligimet tatimore dhe në llogarinë e Trustit Pensional i Kursimeve të paguhen Kontributet pensionale të punëtorëve, nga mjetet e Donatorëve janë ndalur në burim dhe janë paguar 10 % e Kontributit Pensional për punëtorët e angazhuar në këto projekte të financuara nga Donatorët.

Shënim: Të dhënat e hollësishme për secilën pagesë (përfituesi dhe shumën e paguar dhe të ndalura) janë dhënë në **Shtesën e posaçme XIV.**


V - SHPENZIMET KOMUNALE- Kodi 132

Për këtë kategori ekonomike buxheti i lejuar në fillim të vitit 2022 ishte **73,000.00 €**. Shpenzimi i buxhetit të lejuar për këtë kategori ekonomike ishte sikur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 10- Shpenzimi i buxhetit për Shpenzime komunale për I-XII 2022

KODET EK.	EMËRTIMI I KODIT:	Shpenzimet Komunale I-XII 2021
13210	RRYMA	22,931.91
13220	UJI	11,013.57
13230	MBETURINAT	1,715.22
13250	TELEFON FIKS	1,947.17
	TOTAL: I-XII 2021	37,607.87

Grafiku nr. 4- Shpenzimet komunale sipas kodeve ekonomike gjatë vitit 2022



Në krahasim me planin e shpenzimit për këtë periudhë të dhënat janë sikur në tabelën e mëposhtme. Tabela nr. 11- Shpenzimi i buxhetit për Shpenzime Komunale në krahasim me planin

Muaji	Plani:	Shpenzimi:	%
1	3	4	5(4/3*100)
Janar	0	0	0
Shkurt	9,000.00	5,097.74	56.64
Mars	8,000.00	5,825.72	72.82
Prill	6,000.00	4,090.69	68.18
Maj	6,000.00	3,510.07	58.50
Qershor	5,000.00	2,858.40	57.17
Korrik	5,000.00	2,818.87	56.38
Gusht	5,000.00	0	-
Shtator	6,000.00	4,894.90	81.58
Tetor	6,000.00	2,223.33	37.06
Nëntor	8,500.00	3,065.21	36.06
Dhjetor	8,500.00	3,222.94	37.92
Gjithsej I-XII/2022	73,000.00	37,607.87	51.52

Buxheti për këtë kategori ekonomike është shpenzuar 51.52 % nga shuma e planifikuar.

VI - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE-Kodi 200

Për këtë kategori buxhetore, për këtë vit, janë të lejuara 100,000.00 € fonde.
Në këtë periudhë nuk është kryer asnjë pagesë.

Zotimi është kryer në muajin Prill/2022, ndërsa shpenzimi është realizuar në muajin Nëntor/2022. Këto mjete janë ndarë për pagesat e bursave të studenteve për vitin akademik 2020/2021. Shuma e shpenzuar e nga kategoria Subvencione dhe transfere është 99,446.40 €.

VII - INVESTIME KAPITALE- Kodi 300

Buxheti i lejuar për këtë kategori ekonomike ishte **200,000.00 €**.

Shpenzimi është planifikuar të realizohet si vijon: Mars/2022- vlera 110,000.00, Maj/2022- vlera 10,000.00. Korrik/2022- vlera 15,000.00 dhe Shtator/2022- vlera 65,000.00.

Janë identifikuar nevojat e shpenzimit të investimeve kapitale. Mjetet e zotuar në kuader të kodit të projektit 12533 janë paraqitur në tabelarin e mëposhtëm.

Tabela nr. 12-Zotim/obligimi i mjeteve buxhetore për kapitale në krahasim me planin

Muaji	Plani i Zotimit:	Realizimi	Përqindja e realizimit
1	2	3	Gjiths. 4 (3/2*100)
Janar	-		-
Shkurt	175,000.00		-
Mars	-		-
Prill	10,000.00		-
Maj	-		-
Qershor	15,000.00		-
Korrik	-		-
Gusht	-		-
Shtator	-		-
Tetor	-		-
Nëntor	-	48,186.50	
Dhjetor	-	132,992.97	
Gjithsej I-XII/2022	200,000.00	181,179.47	90.59


Buxheti nuk është realizuar 100% sepse çmimet ofertuese ishin nën çmimet e planifikuara, si dhe nuk kishte afat kohor ligjor për hapje të procedurave tenderuese për shpenzimin e mjeteve të mbetura në shumë 18,320.53. Realizimi **90.59 %**.

VIII – DONACIONET

Gjendja e donacioneve në fillim të vitit 2022 dhe realizimi gjatë vitit 2022 ishte si vijon:
Tabela nr. 13- Gjendja e donacioneve të shpenzuara me deri me datën 31.12.2022

Nr.	Emërtimi i donacionit:	Vlera e donacionit	Të shpenzuara gjatë vitit 2020	Gjendja 31.12.2020	Të shpenzuara gjatë vit. 2021	Gjendja 31.12.2021	Të shpenzuara periudha I-XII 2022
1	DI-PHDICTKES KBP- 92089	176,414.00	16,725.00	159,689.00	64,261.00	95,428.00	13,902.00
2	SMART 4ALL KBP 94973	106,850.00	6,987.58	99,862.42	8,528.20	91,334.22	6,147.55
3	QUADIC KBP 94996	48,970.00	17,110.00	31,860.00	4,809.90	27,050.10	15093.98
4	RESEARCHECULT KBP-92085	50,400.00	5,174.00	45,226.00	11,809.00	33,417.00	10,345.99
5	T2P-KBP 94974	21,150.00	-	21,150.00	19,150.00	2,000.00	-
6	QEVERIA E FRANCËS KBP-95109	600.00	-	-	-	600.00	1,200.00
7	BESTSDI KBP-99711	1,080.00	-	-	1,080.00	-	-
8	MENTORIMI PER NDRYSH. KLIM. KBP 96633	-	-	-	-	-	2,020.00
9	DONACION I BRENDSHËM KBP-92141	4,800.00	-	-	-	-	4,800.00
	GJITHSEJ	410,264.00	45,996.58	357,787.42	109,638.10	249,829.32	53,509.52

Grafiku nr. 5- Paraqitja grafike e projekteve të donatorëve



VIII.1. PROJEKTI DI-PHDICTKES (KB - 92089)

Projekti është qeverisur dhe të dhënat për këtë projekt mbahen sipas kërkesave të cilat i përcakton donatori lidhur me mënyrën e mbajtjes, shumat e shpenzimit dhe raportimit.

Ky projekt është aktiv dhe ka të bëjë me hartimin dhe shpërndarjen e një programi kombëtar të doktoratës në TIK.

VIII.2. PROJEKTI SMART 4ALL (KB - 94973)

Universiteti i Prizrenit në këtë projekt është në konzorcium me 25 partner europian në fushat si; transporti i dixhitalizuar, bujqësi e dixhitalizuar r etj. Ky projekt është financuar nga programi HORIZON 2020.

VIII.3. QUADIC (KB- 94996)

Qëllimi i këtij projekti është të përmirësoj sigurinë e arsimit të lartë në Kosovë, duke ndërtuar kapacitete institucionale për mardhënie ndërkombëtare.

VIII.4. RESEARCHECULT (KB 92085)

Qëllimi i këtij projekti është të mbështesë rritjen e kulturës kërkimore në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, përmirësimi i strategjisë universitare për botimin e punës kërkimore-shkencore përmes zhvillimit të standardëve të njohura ndërkombtarisht për revista shkencore.

VIII.5. DONACIONI T2P (KB 99711)

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i Qendrës për Inovacion dhe Punësim, qendër e cila tani më është funksionale dhe e vendosur në Fakultetin Ekonomik të Universitetit dhe zhvillon aktivitetet të cilat janë të parapara me këtë projekt, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm të studentëve si, dhe gjithë personelin akademik të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.

VIII.6. QEVERIA E FRANCEZE (KBP-95109)

Qeveria franceze financon mobilitetin e studenteve te cilet aktualisht janë ne Bordeaux te Francës.

VIII.7. BESTSDI (KBP-99711)

Qëllimi i projektit BESTSDI është të përmirësoj kurrikulën në universitetet partnere nëpërmjet futjes së koncepteve të infrastrukturës së të dhënave hapësinore (SDI) dhe qeverisjes elektronike, si dhe zgjerimit të koncepteve digjitale në menaxhimin e të dhënave hapsinore dhe infrastrukturës së saj të rrjetit, të ndjekura nga standardet dhe cilësitë. Kohëzgjatja e projektit është 3 vjet duke filluar nga 15 tetor 2016

VIII.8. DONACION I BRENDSHËM(KBP-92141)

XII - TË HYRAT VETANAKE-Kodi 500

Të hyrat e paguara në UUHP janë të krijuara kryesisht nga pagesat e studentëve (regjistrimi i semestrit dhe certifikata të notave, certifikata e diplomave dhe të hyra nga qiraja e byfësë brenda kampusit).

Këto të hyra janë sikur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 14- Të hyrat vetanake sipas muajve -Kodi 50, Nënkodi 50409- Partecipimet

Muaji	Të hyrat nga partic.i studen.	Të hyrat nga qiraja	Rimbursi.e partic.	Anuli rimbur.	Gjithsej rimburs.	Gjithsej
Janar	8,097.50	-			-	8,097.50
Shkurt	1,818.50	-			-	1,818.50
Mars	13,559.00	-	-	-	-	13,559.00
Prill	6,536.50	-			-	6,536.50
Maj	507.50	-			-	507.50
Qershor	6,374.50	-			-	6,374.50
Korrik	5,133.50	500.00	-		-	5,633.50
Gusht	162.50	-			-	162.50
Shtator	4,065.00	-	-		-	4,065.00
Tetor	6,492.00	290.00				6,782.00
Nëntor	12,051.50		(25.00)			12,026.50
Dhjetor	5,567.00	660.00				6,227.00
Totali:	70,365.00	1,450.00	(25.00)	-	-	71,790.00

Siç shihet nga të dhënat, këto të hyra në këtë periudhë janë 71790.00 € dhe ato janë të barazuara me MASHTI dhe MFPT. Të hyrat janë nga: partecipimet e studenteve 70365.00 € dhe nga qiraja 1,450.00€, kthimi i partecipimit 25.00 €.

Planifikimi buxhetor për të hyrat vetjake është 68,000.00€. Kuptohet kjo renje për shkak të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/64 datë 12.02.2021 për lirim nga pagesa e semestrit veror dhe Udhëzimit Administrativ të MASHTI 09/2021 datë 17.09.2021 për lirim nga pagesa e semestrave të studenteve. Ralizimi është në vlerë 70.365.00

Sa i përket llogarive të arkëtueshme, qiramarrësi “Te Syla” (Restaurant Studenti) ka obligime të papaguara ndaj UUHP-së me perfundim të dt.31.12.2022 shumen prej 2,496.22 € (Qiraja për objekte publike 910.00€ dhe Shpenzimet e ujit 1,586.22 €). Qiraja mujore që operatori ekonomik obligohet të paguaj UUHP është 250 457,072.68 muajt e verës (7 muaj) dhe 330.00 muajt e dimrit (5 muaj). Muajve të dimrit shfrytëzon nxemjen qendrore nga UUHP. Nderkaq me Vendimin nr.01-389 të dt.05/09/2022 Keshilli Drejtues duke aprovuar propozimin e komisionit të krijuar ad-hok për këtë çështje, ndër të tjera këtij operatori i ka falur borgjin e qirase në shumen prej 3,400.00€. Ndersa shuma e lartecekur është borgj i faturuar.

X- PARAJA E IMËT (CASH)

Paraja e imët - Arka

Në këtë periudhë është bërë një mbushje të parasë së imët, sikur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 15- Paraja e imët-mbushja dhe shpenzimi

Muaji	Gjendja në fillim	Pagesat	Gjendja në fund-KTHIMI
Janar	-	-	-
Shkurt	1,000.00	-	-
Mars	-	-	-
Prill	-	-	-
Maj	-	-	-
Qershor	-	-	-
Korrik	-	-	-
Gusht	-	-	-
Shtator	-	-	-
Tetor	-	-	-
Nëntor	-	-	-
Dhjetor	-	994.64	5.36
Gjithsej:	1,000.00	994.64	5.36

Është marrë një mbushje (patty cash), 1,000 €, ajo ende nuk është shpenzuar dhe është barazuar kthimi. Pagesat përmes Patty Cash-it (Arkës) janë 994.64 dhe kthimi i mjeteve në Xhirollogarinë e Thesarit 5.36 €.

Barazimi – Mbyllja e Avancit të patty cash-it) është realizuar me datë 23.2022.

XI - OBLIGIMET E PAPAGUARA

a) **Të bartura nga viti 2021**- Obligimet e papaguara të bartura në vitin 2022 janë **266,518.07€ (Paga dhe shtesa - 263,018.00, Mallra dhe shërbime - 3,328.20, Shpenzime Komunale - 171.87)**. Tek kategoria e Pagave dhe Shtesave obligime të bartura nga viti i kaluar janë krijuar, sepse në mungesë të fondeve për të i paguar orët shtesë dhe honoraret si dhe komisionet e ndryshme të personelit akademik në fund të tremujorit të vitit 2021, ato janë bartur në vitin 2022 dhe janë paguar me pagat e muajit Janar 2022.

Ndërsa tek kategoria e mallarve dhe shërbimeve si dhe shpenzimet komunale janë fatura të cilat kanë arritur në Universitetin e Prizrenit pas skadimit të afateve për pagesë në fund të vitit 2021. Këto obligime janë paguar në tërësi gjatë tremujorit të parë të vitit 2022.

b) **Obligimet e papaguara në vitin 2022**

Obligimet e papaguara të vitit 2022 që barten në vitin 2023 janë **300,895.36 (Paga dhe shtesa - 285,238.00, Mallra dhe shërbime – 1,004.70, Shpenzime Komunale – 154.16)**.

XII - REKAPITULIM – PLANI DHE SHPENZIMI I TËRËSISHËM I BUXHETIT TË LEJUAR PËR PERIUDHËN I-XII 2022

Shpenzimi i tërësishëm i buxhetit për vitin 2022 në krahasim me buxhetin e lejuar ishte sikur në tabelën e mëposhtme:


Tabela nr. 16-Shpenzimet e tërësishme të buxhetit

Kategoria ekonomike:	Kodi:	Shuma e planifikuar:	Shuma me Rishikim:	Shuma e shpenzuar:	Përqindja	Struktura %
1	2	3	4	5	6(5/4)	7(Shpenz/Totali)
Paga dhe shtesa (BK)	11	2,070,728.00	2,527,800.68	2,527,800.68	100	72.75
Mallra dhe shërbime	13	700,000.00	730,000.00	628,422.99	86.09	18.09
Shpenzime komunale	14	73,000.00	43,000.00	37,607.87	87.46	1.08
Subvencione	20	100,000.00	100,000.00	99,446.40	99.45	2.86
Kapitale	30	200,000.00	200,000.00	181,179.19	90.59	5.21
Gjithsej:		3,143,728.00	3,600,800.68	3,474,457.13	96.49	100

Shpenzimi i tërësishëm i buxhetit në krahasim me Rishikimin buxhetor është realizuar **96.49%** (kolona 6.). Struktura e shpenzimit të buxhetit është si në vijim:


- Paga dhe shtesa **72.75%** ;
- Mallra dhe shërbime **18.09%**
- Shpenzime komunale **1.08%**,
- Subvencione **2.86%** dhe
- Kapitale **5.21%**

Grafiku nr. 6- Përmbushja e planit të shpenzimit të buxhetit -sipas kategorive ekonomike



Grafiku nr. 7- Struktura e Përmbushjes së planit të shpenzimit të buxhetit në % - sipas kategorive ekonomike

Struktura e shpenzimit të buxhetit gjatë vitit 2022 në %



■ Paga dhe shtesa (BK)
 ■ Mallra dhe shërbime
 ■ Shpenzime komunale
 ■ Subvencione
 ■ Kapitale

XIII - PËRFUNDIME

1. Janë paguar obligimet e mbetura të papaguara, kategoria e pagave dhe shtesave si dhe faturat të cilat kanë arritur pas afatit të fundvitit për pagesë nga viti 2021 në shumë prej 266,518.07€;
2. Në kategorinë ekonomike Paga dhe shtesa buxheti, u shfrytëzua në tërësi. Shpenzimi i buxhetit për paga është më i madh se e buxhetit vjetor i planifikuar (2,070,728.00€) për 22.07 %. Vlera e shpenzuar për paga dhe shtesa është **2,527,800.68€**. Pra shuma prej 457,072.68 € janë fonde më tepër të shpenzuara se planifikimi fillestar buxhetor.
3. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime buxheti u shfrytëzua 86.09 %, që tregon se kemi një shpenzim të menaxhuar mirë. Kemi pasur mjete të ndara për shërbime të sigurimit të objektit. mirëpo OE e ka ndërprerë kontratën në mënyrë të njëanëshme. Po ashtu nuk kemi kontraktuar dhe paguar mirmbajtjen e SMU-s së.
4. Në kategorinë e Shpenzimeve Komunale buxheti është shfrytëzuar 87.46 %, që është nivel i zakonshëm i shpenzimit. Nga kjo kategori me rastin e Rishikimit buxhetor shuma prej 30,000.00 € është bartur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve;
5. Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve u shpenzuan 99.45 % po thuajse në tërësi mjetet e ndara buxhetore për këtë kategori (Bursat Studentore).
6. Poashtu në kategorinë ekonomike të Kapitaleve buxheti u shfrytëzua 90.59 %. Kontraktimi i punëve është kryer me vonesë për shkak të ankesave të OE në OSHP.
7. Fonde të shpenzuara nga donacionet janë: Mallra dhe shërbime 44,519.52 (83.2%) dhe Kapitale 8,990.00 (16.8 %). Vlerat totale e donacioneve të shpenzuara është 53,509.52 €.
8. Është bërë një mbushje e parasë së imët (1,000.00 €). Është shpenzuar në harmoni me ligjin. Vlera e shpenzuar 994.64 dhe kthimi i mjeteve 5.36 €)
9. Është bërë barazimi i të hyrave vetjake prej 71,790.00 €.
10. Çdo muaj janë deklaruar në MASHTI-MFPT obligimet e papaguara nga muajt paraprak, në harmoni me ligjin.
11. Janë deklaruar dhe paguar në ATK me kohë Obligimet për TMB dhe Kontribute pensionale për punëtorët që nuk paguhen përmes thesarit, si dhe pagesat e komisioneve nga donatorët të cilët kanë marrëveshje me të punësuarit e UUHP-së.
12. Obligimet e papaguara të UUHP së të cilat duhet të paguhen në vitin 2023 janë si më poshtë:
 - Paga dhe shtesa – 285,238.00,
 - Mallra dhe shërbime -1,004.70
 - Shpenzime komunale- 154.16
 - Kapitale – 14499.00
 Gjithsej – 300,895.86, obligime të papaguara në vitin 2022 që barten në vitin 2023.

Tabela nr. 19- Tabela e planifikimit dhe shpenzimit vjetor për paga 2017-2022

Periudha Fiskale	Pagat sipas Ligjit mbi Ndarjet buxh.	Pagat e shpenzuara	Diferenca Planifikim-Ralizim	Realizimi në %
1	2	3	4 (2-3)	5(3/2*100)
2017	1,624,518.00	1,845,818.12	-221,300.12	113.62
2018	1,630,346.00	2,064,248.80	-433,902.80	126.61
2019	1,853,771.72	2,249,353.83	-395,582.11	121.34
2020	1,650,728.00	2,209,025.01	-558,297.01	133.82
2021	1,650,728.00	2,230,311.69	-579,583.69	135.14
2022	2,070,728.00	2,527,800.68	-457,072.68	122.07

XIV - BURIMET E TË DHËNAVE

1. Të dhënat zyrtare nga Free-balanci;
2. Burime të Shërbimit financiar të UUHP;
3. Të dhënat nga Analizat mujore të MASHTI;
4. Plani i rrjedhës së parasë së UUHP;
5. Të dhënat e pranuar nga Thesari për Donacione

XV – SHITESAT

(Shtesat janë dhënë posaçërisht, ndaras nga ky raport, por janë pjesë përberëse e tij)

- Raporti i Analizave të Llogarive – Detajet për Periudhën Fiskale Janar-Shtator 2022.